



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M


Nr. 1, datë 10. 06. 2020

PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR.
BASHKIA GRAMSH

Në mbështetje të nenëve 7, 20 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit" i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Gramsh Nr. 15, datë 25.02.2020 "Mbi miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Gramsh", me propozimin e Bashkisë Gramsh, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Gramsh, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtëm:
 - a) Strategjia Territoriale, shoqëruar me përmbledhjen e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit;
 - b) Plani i Zhvillimit të Territorit, shoqëruar me Shtojcën I, sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit;
 - c) Rregullorja e Planit;
 - d) Vlerësimi Strategjik Mjedisor;
 - e) Materiali hartografik:
 - i. Vizioni strategjik;
 - ii. Ndarja e territorit në 5 sisteme;
 - iii. Ndarja e territorit në njësi;
 - iv. Përdorimi i propozuar i tokës;
 - v. Infrastruktura e transportit;
 - vi. Fazat e zbatimit të PPV-së.
2. Në Zonat e Rëndësishme Kombëtare brenda territorit administrativ të Bashkisë Gramsh, shpallur si të tilla nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit apo me vendime të veçanta, autoriteti përgjegjës për miratimin e Planeve të Detajuara është Këshilli Kombëtar i Territorit.

- 
3. Në Zonat e përcaktuara si të Rëndësishme Kombëtare dhe për Objektet e Rëndësishme Kombëtare, përfshirë edhe ato që ngrihen në pronat shtetërore të patransferuara të njësitë e qeverisjes vendore, autoriteti përgjegjës për miratimin e Lejeve të Zhvillimit dhe Ndërtimit, është Këshilli Kombëtar i Territorit.
 4. Gjatë hartimit të Planeve të Detajuara Vendore, projekteve strategjike, projekteve pilot të zhvillimit, si dhe çdo projekti tjetër për zhvillimin e territorit, Bashkia Gramsh duhet të bazohet në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislati në fuqi dhe nga Plani i Përgjithshëm Vendor.
 5. Ngarkohet Bashkia Gramsh për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, si dhe për bashkërendimin e punës në zbatim të këtij plani me AKPT-në, Ministrinë përgjegjëse dhe të gjitha autoritetet e tjera shtetërore, sipas fushave të përgjegjësisë.
 6. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohen vendimet e miratuara më parë nga KRRTRSH/KKT për territorin administrativ të Bashkisë Gramsh, përfshirë, por pa u kufizuar në to, si më poshtë:
 - Vendim i KRRTRSH Nr. 11, datë 21.07.2009 "Detyrë Projektimi për Planin e Përgjithshëm Rregullues të Qytetit të Gramshit.
 7. Planot e detajuara vendore dhe lejet e ndërtimit të miratuara në zbatim të dokumenteve të planifikimit të mëparshme, të cilave nuk u ka mbaruar afati i zbatimit, mbeten në fuqi.
 8. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËRIT ENJË

BELINDA BALLEKU

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

